

## KARTA E TOKES

### HYRJE

Ne ndodhemi në një moment kritik të historisë së Tokës, një kohë kur njerëzimi duhet të zgjedhë të ardhmen e tij. Meqenëse bota është duke u bërë gjithmonë e më e ndërvarur dhe e brishtë, e ardhmja, njëkohësisht përmban rrezik të madh dhe premtim të madh. Për të ecur përpara, ne duhet të kemi të qartë që, në mes të një shumëlojshmërie të mrekullueshme të kulturave dhe formave të jetës, ne jemi një familje njerëzore dhe një komunitet tokësor me një fat të përbashkët. Ne duhet të bëhem bashkë për të ngritur një shoqëri globale të bazuar në respektin ndaj natyrës, të drejtave universale të njeriut, drejtësisë ekonomike dhe një kulture paqësore. Për të arritur këtu është imperative që ne, banorët e Tokës, të deklarojmë përgjegjësinë tonë për njëri-tjetrin, për komunitetin më të madh të jetës dhe për brezat e ardhshëm.

### Toka, Shtëpia Jonë

Njerëzimi është një pjesë e një universi të madh në zhvillim. Toka, shtëpia jonë, gjallon me një komunitet unikal të jetës. Forcat e natyrës e bëjnë ekzistencën një aventurë të vështirë e të pasigurt, por Toka ka prodhuar kushtet thelbësore drejt evolucionit të jetës. Qëndrueshmëria e komunitetit të jetës dhe mirëqenia e njerëzimit varen nga mbrojtja e një biosfere të shëndetshme, me të gjitha sistemet e saj ekologjike, një llojshmëri e pasur e bimëve dhe kafshëve, toka pjellore, ujëra të kulluara dhe ajër i pastër. Mjedis global, me burimet e tij të fundme, është një shqetësim i përbashkët për të gjithë njerëzit. Mbrojtja e vitalitetit, shumëlojshmërisë dhe bukurisë së Tokës është një besim i shenjtë.

### Situata Globale

Modelet mbizotëruese të prodhimit dhe konsumit po shkaktojnë shkatërrim mjedisor, sosje të burimeve dhe një zhdukje masive të specieve. Komunitetet po vendosen mbi

mina. Përfitimet nga zhvillimi nuk po shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe hendeku midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet. Padrejtësitë, varfëria, injoranca dhe konfliktet e dhunshme po përhapen dhe janë shkak i vuajtjeve të mëdha. Një rritje e paprecendentë e popullsisë njerëzore ka mbingarkuar sistemet ekologjike dhe sociale. Bazat e sigurisë globale janë kërcënuar. Këto trende janë të rezikshme por jo të paevitueshme.

## **Sfidat që na presin**

Zgjedhja na takon neve: të formojmë një partneritet global për t'u kujdesur për Tokën dhe njëri-tjetrin, apo të rrezikojmë shkatërimin e vvetves dhe të diversitetit të jetës. Në sistemin e vlerave tona, institucionet dhe mënyrën e jetesës kërkohen ndryshime fondamentale. Ne duhet të kuptojmë që, kur nevojat bazike janë plotësuar, zhvillimi njerëzor konsiston në radhë të parë drejt të qenit më shumë, dhe jo të pasurit më shumë. Ne kemi njohuri dhe teknologji për të prodhuar për të gjithë dhe për të reduktuar impaktin tonë ne mjedis.

Emergjenca e një shoqërie civile globale po krijon oportunitete të reja për të ndërtuar një botë demokratike dhe njerëzore. Sfidat tona mjedisore, ekonomike, politike, sociale dhe shpirterore jane të ndërlidhura dhe së bashku ne mund të ideojmë zgjidhje gjithëpërfshirëse.

## **Përgjegjësia universale**

Për të realizuar këto aspirata ne mund të vendosim të jetojmë me një sens të përgjegjësisë universale duke identifikuar veten tonë me të gjithë komunitetin e Tokës, sikurse me komunitetet tona lokale. Ne jemi, njëkohësisht, qytetarë të kombeve të ndryshme dhe të një bote, në të cilën, lokalja me globalen janë të lidhura. Çdokush ndan përgjegjësi për mirëqenien e tashme dhe të ardhme të familjes njerëzore dhe të një bote më të madhe gjallesash. Shpirti i solidaritetit njerëzor dhe lidhjeve

familjare me të gjitha qeniet e gjalla është forcuar, ndërsa ne jetojmë me nderim për misterin e ekzistencës, mirënjojje për dhuratën e jetës dhe përulësi ndaj vendit të njeriut në natyrë.

Ne, urgjentisht, kemi nevojë për të ndarë një vizion të vlerave themelore, për të siguruar një bazë etike për komunitetin botëror në zhvillim. Prandaj, të bashkuar tek shpresa, ne shpallim parimet e ndërvarura që vijojnë, për një mënyrë të qëndrueshme të të jetuarit si një standard i përbashkët, nga të cilat duhet të udhëhiqet dhe vlerësohet sjellja e të gjithë individëve, organizatave, bizneseve, qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare.

## **Parimet**

### **I. RESPEKT DHE KUJDES PËR KOMUNITETIN E JETËS.**

- 1. Respekt për Tokën dhe jetën në gjithë diversitetin e saj.**
  - a. Të pranojmë që të gjitha qeniet e gjalla janë të ndërvarura dhe çdo formë e jetës ka vlerë, pavarësisht nga dëmi që mund t'u shkaktojë qenieve njerëzore.
  - b. Të afirmojmë besimin në dinjitetin e lindur të gjithë qenieve të gjalla dhe në potencialin intelektual, artistik, etik dhe shpirtëror të njerëzimit.
- 2. Kujdesi për komunitetin e jetës me mirëkuptim, dhembshuri dhe dashuri.**
  - a. Të pranojmë që, bashkë me të drejtën për zotërimin, menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, vjen detyra për të parandaluar rrezikun mjedisor dhe për të mbrojtur të drejtat e njerëzve.
  - b. Të pohojmë që me lirinë, njohjen dhe fuqinë në rritje vjen përgjegjësia në rritje për të promovuar të mirën e përbashkët.

**3. Ndërtimi i shoqërive demokratike që janë të drejta, gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe paqësore.**

- a. Të sigurohemi që komunitetet në të gjitha nivelet të garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe të krijojë gjithësecili një mundësi për të realizuar potencialin e tij apo të saj.
- b. Të promovojmë drejtësi sociale dhe ekonomike, duke u mundësuar të gjithëve të arrijnë një jetesë të sigurt dhe kuptimplotë, që të jetë ekologjikisht e përgjegjshme.

**4. Sigurimi i mirëqenies dhe bukurisë së Tokës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.**

- a. Të kuptojmë që liria e veprimit të çdo gjenerate duhet të vlerësohet nga nevojat e brezave të ardhshëm
- b. T'u transmetojmë brezave të ardhshëm vlerat, traditat dhe institucionet që mbështesin lulëzimin afatgjatë të komuniteteve të njerëzve dhe lulëzimin ekologjik të Tokës.

**Në mënyrë që të përbushim këto katër angazhime të mëdha , është e nevojshme:**

## **II. INTEGRITETI EKOLOGJIK**

**5. Të mbrojmë dhe të restaurojmë integritetin e sistemeve ekologjike të Tokës, me shqetësimin e veçantë për diversitetin biologjik dhe procest natyrore që mbështesin jetën.**

- a. Të adoptojmë në të gjitha nivelet planet dhe rregullat e zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat e bëjnë ruajtjen e mjedisit dhe rehabilitimin, integrale për të gjitha nismat e zhvillimit.
- b. Të vendosim dhe të mbrojmë praktikisht natyrën dhe rezervat e biosferës, duke përfshirë tokat e egra dhe zonat detare, të mbrojmë sistemet mbështetëse të jetës në Tokë, të mirëmbajmë biodiversitetin dhe të ruajmë trashëgiminë tonë natyrore.
- c. Të nxisim shërimin e specieve dhe ekosistemeve të rrezikuara.

- d. Të kontrollojmë dhe të çrrënjosim organizma jo amtarë apo gjenetikisht të modifikuar, të rrezikshëm për speciet vendase dhe mjedisin dhe të parandalojmë hyrjen e këtyre organizmave të rrezikshëm.
- e. Të menaxhojmë përdorimin e burimeve të rinovueshme si uji, toka, produktet e pyllit dhejeta e detit në mënyrë që të mos tejkalojë nivelet e rigjenerimit dhe të ndihmojmë shëndetin e ekosistemeve.
- f. Të menaxhojmë nxjerrjen dhe përdorimin e burimeve të parinovueshme si mineralet dhe lëndët djegëse fosile në mënyrë që të minimizohet sosja e tyre dhe të shkaktohet dëm jo serioz mjedisor.

## **6. Të parandalojmë rrezikun si metoda më e mirë e mbrojtjes së mjedisit dhe, kur njojja është e kufizuar, të aplikojmë një qasje parandaluese.**

- a. Te hidhemi në veprim për të evitar mundësinë e rrezikut serioz dhe të pakthyeshëm për mjedisin edhe kur njojuritë specifike janë të paplota dhe jo përfundimtare.
- b. Të vendosim në bankën e provës ata që kërkojnë të na bindin se një aktivitet i propozuar nuk shkakton dëme të rëndësishme dhe të vemë para përgjegjësisë palët përgjegjëse për dëmet në mjedis.
- c. Të sigurohem që vendimmarrja i adresohet atyre pasojave të veprimtarisë njerëzore që janë afatgjata, përfshijnë grumbullime të mëdha njerëzish, janë indirekte dhe me largësi veprimi në distancë.
- d. Të parandalojmë ndotjen në çdo pjesë të mjedisit dhe të mos lejojmë prodhimin e substancave toksike radioaktive apo substancave të tjera të rrezikshme.

Të evitojmë aktivitete militare dëmtuese për mjedisin.

## **7. Të miratojmë modele të prodhimit, konsumit dhe riprodhimit që mbrojnë kapacitetet rigjeneruese, të drejtat e njeriut dhe mirëqenien e komunitetit.**

- a. Të reduktojmë, ripërdorim dhe riciklojmë materialet e përdorura në sistemet e prodhimit dhe konsumit dhe të sigurohem që mbetjet e hedhura mund të jenë të asimilueshme nga ekosistemet.
- b. Të veprojmë me vetëpërmbajtje dhe eficencë në përdorimin e energjisë dhe të mbështetemi gjithmoneë e më teper në burimet e energjisë së rinovueshme si energjia diellore dhe ajo e erës.
- c. Të nxism zhvillimin, përshtatjen dhe transferimin e barabartë të teknologjive të shëndetshme për mjedisin.
- d. Të përfshijmë kostot e plota mjedisore të mallrave dhe shërbimeve në çmimin e shitjes dhe t'u mundësojmë konsumatorëve të identifikojnë produktet që arrijnë standarde të larta sociale dhe mjedisore.
- e. Të sigurojmë qasje universale ndaj kujdesit shëndetësor që nxit shëndet riprodhues dhe riprodhim të përgjegjshëm.
- f. Të adoptojmë stil jetese që vë theksin në cilësinë e jetës dhe në mjaftueshmërinë materiale në një botë të fundme.

## **8. Të avancojmë studimin mbi qëndrueshmërinë ekologjike dhe të nxism shkëmbimin e hapur dhe aplikimin e gjerë të njojurive të kërkua.**

- a. Të mbështesim bashkëpunimin shkencor dhe teknik ndërkombëtar mbi qëndrueshmërinë me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të vendeve në zhvillim.
- b. Të njohim dhe të mbrojmë njojuritë tradicionale dhe urtësinë shpirtërore në të gjitha kulturat që kontribojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien njerëzore.
- c. Të sigurohem që informacioni me rëndësi jetësore për shëndetin njerëzor dhe mbrojtjen e mjedisit, përfshirë informacionin gjenetik, mbeten në dispozicion në domeinin publik.

### **III. DREJTËSIA SOCIALE DHE EKONOMIKE**

#### **9. Zhdukja radikale e varfërisë si një imperativ etik, social dhe mjedisor.**

- a. Të garantojmë të drejtën e ujit të pijshëm, ajrit të pastër, sigurisë së ushqimit, tokës së pakontaminuar, strehimit dhe sigurisë shëndetësore duke shpërndarë drejt burimet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkuara.
- b. Të fuqizojmë çdo qenie njerëzore me edukimin dhe burimet që sigurojnë një jetesë të qëndrueshme dhe të kujdesemi për të krijuar siguri sociale dhe rrjete të sigurta për ata që janë të paaftë të mbështesin vetveten
- c. Të pranojmë të shpërfillurit, të mbrojmë të dobëtit, t'u shërbejmë të vuajturve dhe t'u mundësojmë atyre të zhvillojnë kapacitetet e veta e të ndjekin aspiratat e veta.

#### **10. Të sigurohemi që aktivitetet ekonomike dhe institucionet e të gjitha niveleve nxisin zhvillimin human në një mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme.**

- a. Të nxism shpërndarjen e barabartë të të mirave brenda kombeve dhe ndërmjet kombeve.
- b. Të rrisim burimet intelektuale, financiare, teknike dhe sociale të kombeve në zhvillim dhe të lehtësojmë ato nga borxhi i vështirë ndërkombëtar.
- c. Të sigurohemi që gjithë tregtia mbështet përdorimin e burimeve të qëndrueshme, mbrojtje të mjedisit dhe standarde progresive të punës.
- d. Të kërkojmë që koorporatat multinacionale dhe organizatat ndërkombëtare financiare të veprojnë me transparencë në të mirën publike dhe t'i mbajmë ata përgjegjës për pasojat e aktiviteteve të tyre.

**11. Të afirmojmë barazinë gjinore dhe barazinë si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurojmë akses universal ndaj edukimit, kujdesit shëndetësor dhe oportuniteteve ekonomike.**

- a. Të sigurojmë të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave dhe t'i japim fund dhunës kundër tyre.
- b. Të nxisim pjesëmarrjen aktive të grave në të gjitha aspektet e jetës ekonomike, politike, civile, sociale dhe kulturore si partnerë të plotë e të barabartë, vendimmarrës, udhëheqës dhe përfitues.
- c. Të forcojmë familjen dhe të sigurojmë rritjen me dashuri dhe siguri të gjithë pjesëtarëve të familjes.

**12. Të përkrahim të drejtat e të gjithëve, pa diskriminim drejt një mjedisi natyral dhe social mbështetës për dinjitetin njerëzor, shëndetin trupor dhe mirëqenien shpirtërore me një vëmendje të veçantë për të drejtat e indigjenëve dhe minoritetet.**

- a. Të eliminojmë diskriminimin në të gjitha format e tij, si atë të bazuar në racat, ngjyrat, seksin, orientimin seksual, fene, gjuhën, dhe atë me origjinë kombëtare, etnike apo sociale.
- b. Të afirmojmë të drejtat e indigjenëve për spiritualitetin e tyre, njohuritë, vendet dhe burimet dhe për praktikimin e një jetese të qëndrueshme që lidhet me ta.
- c. Të nderojmë dhe të mbështesim të rinjtë e komunitetit tonë, t'u mundësojmë atyre të përmbrushin rolin e tyre esencial në krijimin e shoqërisë të qëndrueshme.
- d. Të mbrojmë dhe të restaurojmë vende të shquara për nga rëndësia kulturore dhe shpirtërore.

## **IV. DEMOKRACI, JO DHUNË DHE PAQE**

### **13. Të forcojmë institucionet demokratike në të gjitha nivelet dhe të sigurojmë transparencë dhe llogaridhënie në qeverisje, pjesëmarrje përfshirëse në vendimmarrje dhe akses te drejtësia.**

- a. Të përkrahim të drejtat e gjithësecilit për të marrë informacion të qartë dhe në kohë për çështjet mjedisore dhe gjithë planet dhe aktivitetet që kanë mundësi të kenë impakt tek ta, apo në të cilat ata kanë interes.
- b. Të mbështesim shoqërinë civile lokale, rajonale dhe globale dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të gjithë individëve dhe organizatave të interesa të vendimmarrje.
- c. Të mbrojmë të drejtën për liri të opinionit, të shprehjes, kuvendeve paqësore, shoqatave dhe të drejtën për liri të kundërshtimit.
- d. Të krijohet akses efektiv dhe eficient tek procedurat e pavarura juridike dhe administrative, duke përfshirë mjete juridike dhe dëmshpërblim për dëmin mjedisor dhe kërcënimin ndaj këtij rreziku.
- e. Të eliminojmë korruptionin në të gjitha institucionet publike dhe private.
- f. Të forcojmë komunitetet lokale duke i aftësuar ato të kujdesen për mjedisin e tyre dhe të caktojnë përgjegjësitë mjedisore në nivelet e qeverisjes ku ato mund të kryhen më me efektivitet.

### **14. Të integrojmë në edukimin formal dhe mësimin e gjatë gjithë jetës njohuritë, vlerat dhe aftësitë që nevojiten për një mënyrë të qëndrueshme të të jetuarit.**

- a. Të bëjmë që të gjithë, veçanërisht të rinjtë dhe fëmijët, në sajë të oportuniteteve të edukimit që i fuqizojnë ata, të kontribojnë aktivisht në zhvillimin e qëndrueshëm.

- b. Të nxisim kontributin e artit dhe të shkencave sociale, sikurse edhe të shkencave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- c. Të rrisim rolin e medias në rritjen e ndërgjegjësimit mbi sfidat ekologjike dhe sociale.
- d. Të pranojmë rëndësinë e edukimit moral dhe shpirtëror për një jetesë të qëndrueshme.

**15. Të trajtojmë të gjitha qeniet e gjalla me respekt dhe konsideratë.**

- a. Të parandalojmë mizorinë ndaj kafshëve të mbajtura në shoqëri me njerëzit dhe t'i mbrojmë ato nga vuajtja.
- b. Të mbrojmë kafshët e egra nga metodat e gjuetisë, kurtheve dhe peshkimit që shkaktojnë vuajtje ekstreme, të zgjatura apo të evitueshme.
- c. Të evitojmë ose të eliminojmë deri në masën më të plotë të mundshme marrjen ose shkatërrimin e specieve "non-target" (që gjuhen pa përzgjedhje).

**16. Të krijojmë një kulturë tolerance, jo dhune dhe paqeje.**

- a. Të inkurajojmë dhe të mbështesim mirëkuptimin e ndërsjellë, solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë njerëzve, si dhe brenda e midis kombeve.
- b. Të zbatojmë strategji gjithëpërfshirëse për të parandaluar konfliktet e dhunshme dhe të përdorim zgjidhje bashkëpunuese problemesh për të menaxhuar e zgjidhur konflikte mjedisore dhe mosmarrëveshje të tjera.
- c. Të çmilitarizojmë sistemet kombëtare të sigurisë në nivelin e një pozicioni mbrojtës jo provokativ dhe të konvertojmë burimet militare në synime paqësore, përfshirë edhe restaurimet ekologjike.
- d. Të eliminojmë armët bërthamore, biologjike dhe toksike si dhe të tjetra armë të shfarosjes në masë.

- e. Të sigurohemi që përdorimi i orbitës dhe i hapësirës jashtë saj mbështet mbrojtjen e mjedisit dhe të paqes.
- f. Të pranojmë që paqja është një tërësi e kriuar nga marrëdhënie të drejta me vetveten, personat e tjerë, kultura të tjera, jetë të tjera, Tokën dhe hapësirën më të gjerë, në të cilën, të gjithë janë një pjesë përbërëse.

### **Rruga që na pret:**

Si kurrë më parë në histori, fati i përbashkët na fton të kërkojmë një fillim të ri. Kaq rinotües është edhe premtimi i këtyre parimeve të kësaj Karte të Tokës. Për të përmbusur këtë premtim ne duhet të angazhojmë vetveten për të adoptuar dhe promovuar vlerat dhe objektivat e Kartës.

Kjo kërkon një ndryshim të mendjes e të zemrës. Kjo kërkon një sens të ri të ndërvarësisë globale dhe përgjegjësisë universale.

Ne duhet të zhvillojmë në mënyrë imagjinative dhe të aplikojmë vizionin e një mënyrë të qëndrueshme jetese, lokalisht, si komb, si rajon, dhe globalisht. Diversiteti ynë kulturor është një trashëgimi e çmuar dhe kultura të ndryshme do të gjejnë rrugët e tyre të veçanta për të realizuar këtë vision. Ne duhet të thellojmë dhe përhapim dialogun global që gjenerohet nga Karta e Tokës, nga i cili ne kemi shumë për të mësuar prej kërkimit bashkëpunues të vazhdueshëm drejt të vërtetës dhe urtësisë.

Jeta shpesh përfshin tension ndërmjet vlerave të rëndësishme. Kjo mund të nënkuqtojë zgjedhje të vështira. Megjithatë, ne mund të gjëjmë rrugë për të harmonizuar diversitetin me unitetin, ushtrimin e të drejtës së lirisë me të mirën e përbashkët, objektivat afatshkurtra me qellimiet afatgjata. Çdo individ, familje, organizatë dhe komunitet ka një rol vital për të luajtur. Artet, shkencat, fetë, institucionet edukuese, media, bizneset, organizatat joqeveritare dhe qeveritë janë të gjitha të thirrura për të ofruar një lidership kreativ.

Partneriteti ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile, dhe bizneseve është esencial për një qeverisje efektive.

Me qëllim që të ndërtojmë një komunitet të qëndrueshëm global, kombet e gjithë botës duhet të rinojnjë angazhimin e tyre ndaj Kombeve të Bashkuara, të përbushin detyrimet e tyre nën marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare dhe të mbështesin zbatimin e parimeve të Kartës së Tokës me një instrument ndërkombëtar ligjërisht të detyrueshëm për mjedisin dhe zhvillimin.

Le të jemi ne një zile që do të zgjojë një nderim të ri për jetën, firma që vendos për të arritur qëndrueshmërinë, përshtypjetuesi i luftës për drejtësi dhe paqe dhe festimi plot gjëzim i jetës.

### Origjina e Kartës së Tokës

Karta e Tokës u krijuar nga i pavaruri Komision i Kartës së Tokës, që u mblodh në vijim të Takimit të Tokës të vitit 1992, për të arritur një shprehje me konsensus global të vlerave dhe parimeve për një të ardhme të qëndrueshme. Dokumenti u krijuar për rreth një dekadë përmes një procesi të gjerë konsultimi ndërkombëtar, në të cilin kontribuan mbi pesë mijë persona. Karta është mbështetur zyrtarisht nga mijëra organizata, përfshirë UNESCO dhe IUCN (Bashkimin Botëror të Konservimit). Për më tepër informacion, ju lutemi të viziton [www.EarthCharter.org](http://www.EarthCharter.org).